

Panairi VI Kombëtar i Trashëgimisë dhe Artizanatit, Gjirokastra 2012

Në Gjirokastër nga data 28 - 30 shtator, u zhvillua Panairi VI Kombëtar i Trashëgimisë dhe Artizanatit. Si zakonisht panairi zhvillohet në pazarin e qytetit në fund të shtatorit, në ditët e trashëgimisë dhe organizohet nga Fondacioni “Gjirokastra” (ish GCDO) me mbështetjen e Bashkisë së qytetit ku u prezantuan punët e rreth 120 artizanëve të paraqitura në rrugët pazarit duke tërhequr vëmendjen e turistëve të huaj e vizitorëve nga gjithë rajoni .



Panairi i sivjetshëm përkoi me festimet për 100 vjetorin e Pavarësisë Kombëtare dhe në këtë kuadër u organizua dhe një ekspozitë me produkte artizanale kushtuar kësaj ngjarje të madhe kombëtare. Në ditën e dytë të panairit, u zhvillua Panairi Kulinar me ushqime tradicionale nga rajoni ku vizitorët patën mundësinë të provonin shumëllojshmërinë e pjatave.

Gjatë Panairit u zhvillua një konkurs për përzgjedhjen e disa çmimeve speciale. Një juri e përbërë nga specialistë të huaj dhe vendas të trashëgimisë vlerësoi me çmim të parë “Produkti më i mirë artizanal” gurgdhendësin gjirokastrit, Z. Muhedin Makri për skalitjen e një mulliri që bluan drithëra. Çmimi i dytë iu dha Z. Ervin Gjoni, një krijues violinash nga Tirana, dhe një çmim special për produktin më të mirë kushtuar 100 Vjetorit të Pavarësisë Kombëtare ju dha artizanit nga Saranda Z. Dritan Onjea.

Në ditën e fundit të panairit, u organizua një tryezë e rrumbullakët me bizneset vendore, operatorë turistikë dhe artizanë, për të diskutuar mënyrat e mbështetjes së artizanatit dhe trashëgimisë në Gjirokastër e për të siguruar vazhdimësinë e panairit vjetor. Tryeza e rrumbullakët arriti në përfundimin se Gjirokastra ka ende potenciale të mëdha të pashfrytëzuara për t'u bërë një destinacion turistik e se duhet më shumë punë për të



gjeneruar mundësi që do sillnin të ardhura, çka do të inkurajonte dhe më shumë angazhimin e të rinjve.

Në fund të tryezës së rrumbullakët u krijua një grup pune me emrin "Forumi për Zhvillimin e Turizmit në Gjirokastrë", me qëllim krijimin të një fondi të veçantë për panairin e ardhshëm.